

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Ajo ishte nëna ime", Macaulay Culkin shpërthen në lot në Emmy Awards, fjalët për Catherine O'Hara pr ekin gjithë sallën
ADRESA	https://piranjat.al/showbiz/ajo-ishte-nena-ime-macaulay-culkin-shperthen-ne-lot-ne-emmy-awards-fjale-i104226
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:19:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3ca6498391ab71d69a7011d9ee5e3cb55c7f775cdfd836961e9e8870e5bc1f73
TEKSTI	0413187aa3fdcf7316efaab795e0344d568e3d2fe230165b0bf6311e796c49a0
PAMJA	b38a13648e4dc17f868ed0c8d2b3ff4795a8e6ae0700f3290dd12b3e5fb2589f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2b1278b186dacdc2cc7f9c938b61eb2a4932a1eb39d21c9e084305891352c6a5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/2b1278b186dacdc2cc7f9c938b61eb2a4932a1eb39d21c9e084305891352c6a5

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **shpërbi** nëshkrimi të kontrarës së re me Luis de **41-vjeçari** në Mallakastër kishte kultivuar bimë narkotike n... **Luizim Caka** udhëtonte duke ismiej me dy identitete, **Ilir Metën** GJRK ka rrëzuar kërkesën e tij për **banda shqiptare** në ne kudoq... një hetimi për një rrjet ndërkombëtar **procedur** dy të

[SHOWBIZ](#)

“Ajo ishte nëna ime”, Macaulay Culkin shpërthen në lot në Emmy Awards, fjalët për Catherine O’Hara prekin gjithë sallën

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 15:06



Një skenë që i përloti të gjithë. Macaulay Culkin nuk mundi t’i mbante emocionet teksa u ngjiti në skenën e Emmy Awards 2026 për të nderuar Catherine O’Hara, aktoren që për vite me radhë e njohëm si nënën e tij në “Home Alone”.

Culkin, 46 vjeç, Annie Murphy dhe Dan Levy u bashkuan për homazhin kushtuar aktores së ndjerë, por ishte pikërisht aktori i “Home Alone” ai që përfjetoi momentin më të vështirë. Teksa fliste, zëri iu drodh dhe ai u përlot, duke e quajtur O’Hara-n jo thjesht kolegen e tij, por “mamin” e tij.

“Ka shumë fjalë që mund të përdor për të përshkruar Catherine. Ajo ishte inkurajuese, e ngrohtë, qesharake... por fjala që më vjen në mendje është ‘Mami’”, tha Culkin.

Dhe më pas erdhi rrëfimi që preku gjithë sallën:

“Ajo nuk ishte vetëm një grua dhe nënë për Beau, Matthew dhe Luke, ajo ishte nëna ime.”

Për një moment, Culkin u ndal për të përmbajtur lotët, përpara se të rikthehej te një nga detajet më ikonike të “Home Alone”. Duke iu referuar historisë së filmit, ku Kevin harrohet nga familja e tij, ai tha me humor të dhimbshëm:

“Mund të më ketë harruar... dy herë, por ne do ta kujtojmë gjithmonë.”

Por fjalët e tij nuk mbaruan aty. Culkin tregoi se O’Hara kishte qenë gjithmonë një njeri që “shfaqej” kur ai kishte nevojë për të.

“Si një nënë e mirë, ajo gjithmonë shfaqej kur unë e kërkoja. Sepse kjo ishte Catherine. Këtë bënte ajo: shfaqej. Dhe kjo është më e mira që mund të bëjmë për të sonte, të shfaqemi për të.”

Në fund, aktori iu drejtua publikut me një këshillë që mori edhe më shumë peshë pas fjalëve të tij: “Telefonojeni nënën tuaj sonte. Seriozisht.”

Emocionet vazhduan edhe me Annie Murphy, e cila luajti vajzën e O’Hara-s në “Schitt’s Creek”. Ajo tregoi se pas vdekjes së aktores kishte hasur njerëz të panjohur që e kujtonin Catherine-n dhe i shprehnin dhimbjen për humbjen e saj.

Nga një pasagjer në një avion, te një punonjës karburanti dhe njerëz që e kujtonin përmes batutave të famshme të “Schitt’s Creek”, Murphy tha se këto momente i kishin treguar se sa thellë kishte prekur O’Hara jetën e njerëzve.

“Catherine solli kaq shumë gëzim”, u shpreh ajo.

Edhe Dan Levy e kujtoi aktoren me fjalë të forta, duke thënë se mësimi më i madh që kishte marrë prej saj ishte të thoshte gjithmonë “po”.

“Të thuash po ndaj historive të saj, mënjërisë së saj dhe bujarisë së saj. Këto janë gjërat që do t’i mbani më fort”, tha Levy.

Catherine O’Hara u nda nga jeta më 30 janar 2026, në moshën 71-vjeçare. Më vonë u bë e ditur se shkaku i menjëhershëm i vdekjes ishte një emboli pulmonare, ndërsa kanceri rektal ishte shkaku themelor.

Largimi i saj la pas një valë të madhe reagimesh në Hollywood. O’Hara u nderua edhe në ceremonitë “In Memoriam” dhe mori pas vdekjes një çmim SAG-AFTRA për rolin e saj në “The Studio”.

Por në Emmy Awards, historia u kthye sërish te ajo që publiku kishte parë dikur në ekran: Kevin dhe nëna e tij. Vetëm se këtë herë, Macaulay Culkin nuk po luante një rol. Po i thoshte lamtumirën një gruaje që e kishte konsideruar vërtet “mamin” e tij.

Artikuj te sugjeruar

SHOWBIZ 15 Shtator13:56

[Emrat që shkëlqyen në tapetin e kuq të Emmy 2026, këto ishin yjet më elegantë të mbrëmjes](#)

Ceremonia e ndarjes së çmimeve Emmy 2026 ishte padyshim një nga netët më të mëdha dhe më emocionuese të botës...

SHOWBIZ 15 Shtator11:12

[Ndjesë dhe falenderim! Joz Marku rikthehet me një mesazh!](#)

Këngëtarë ka publikuar në Instagram një fotografi ku shfaqet pranë oxhakut duke lexuar një libër, ndërsa krahas saj ka...

SHOWBIZ 15 Shtator09:33

[“Kam bërë 18 seanca plazmafereze”/ Dëshmia që po qarkullon pas rastit të Mazonakis: Ai u vra nga kriminelë!](#)

Një dëshmi personale për shkëmbimin terapeutik të plazmës (TPE) po tërheq vëmendje në rrjetet sociale pas rastit të...

SHOWBIZ 15 Shtator08:31

[Më pranë se kurrë, zbulohet kur do të nisë Big Brother VIP Kosova](#)

Përgatitjet për edicionin e pestë të “Big Brother VIP Kosova” duket se kanë hyrë në fazën përfundimta...

SHOWBIZ 14 Shtator20:15

[Meghan Markle ekspozon pa dashje vendndodhjen? Videoja që ngre pikëpyetje për sigurinë e familjes](#)

Duka dhe Dukesa e Sussex-it kanë kërkuar respektimin e privatësisë së familjes pas rikthimit në Britani, ndërsa një eks...

SHOWBIZ 14 Shtator20:05

["Më shanë nënën, gruan dhe vajzën", Mozzik vjen me një mesazh të fortë](#)

Reperi i njohur Mozzik ka reaguar ashpër pas pjesëmarrjes së tij në Marshin për Liri në Prishtinë, të organizuar në...

SHOWBIZ 14 Shtator19:23

[“Më vinte të vrisja veten nga dhimbja”, Bledi Strakosha rrëfen betejën me hemorragjinë cerebrale](#)

Një dhimbje koke e fortë, një moment i papritur dhe një situatë që mund t'i ndryshonte gjithçka. Kështu nisi një...

SHOWBIZ 14 Shtator18:30

[Të katër në të njëjtën tribunë! Brad Pitt me Ines de Ramon, përballë ish-bashkëshorti i saj me gruan e re](#)

Brad Pitt dhe Ines de Ramon tërhoqën vëmendjen gjatë finales së meshkujve në US Open, ku çifti u shfaq mjaft i afërt n...

SHOWBIZ 14 Shtator18:25

[Dhimbje e madhe për Genta Ismajlin, këngëtarja humb babain: Një pjesë e shpirtit më iku me ty](#)

Këngëtarja e njohur, Genta Ismajli, ka humbur një nga njerëzit më të rëndësishëm të jetës së saj, ...

SHOWBIZ 14 Shtator18:15

[Në 29-vjetorin e lindjes, Egli Tako poston foton e veçantë: Sot janë të 20-tat e fundit, të falenderoj që nuk u dorëzove vetja ime](#)

Ish-banorja e “BBVA4” njëherazi dhe artistja e njohur Egli Tako feston sot 29-vjetorin e lindjes. Një ditë e veçantë k...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

[FOTO- ‘Mos u kthe më në Shqipëri’/ Edi Rama sul...](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

[EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...](#)

Një shtetë shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij në kultivimin e një forme kanabici me vlerë 4.5 milionë...

ky shprehje i qartë i detyrës së bashkëpunimit të ngushtë midis policisë dhe autoriteteve të drejtësisë.

BOTA 14 Shtator

[“E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite”/ Bash...](#)


Një burrë britanik pranoi sot se kishte droguar dhe përdhunuar gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...


INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video






Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.